

NDRYSHIMI ËSHTË NË DUART TUAJA

QYTETARE(Ë)T MARRIN PJESË, VËZHGOJNË, RAPORTOJNË



OBJEKTIVI QYTETAR
PROJEKT PËR PROMOVIMIN E
TRANSPARENCËS DHE PËRGJE-
GJËSISË NË PROCESET POLITIKE

СТАТИСТИКА | STATISTIKA

4 ГОДИНИ | VITE

28 СЕМИНАРИ | SEMINARE

20 РАБОТИЛНИЦИ | PUNËTORI

1500+ ПРИЛОЗИ | ARTIKUJ

4 ИЗБОРНИ ПРОЦЕСИ | PROCESE ZGJEDHORE

950+ АКРЕДИТИРАНИ НАБЉУДУВАЧИ | VËZHgues TË AKREDITUAR

1000+ ГРАЃАНСКИ НАБЉУДУВАЧИ | VËZHgues QYTETAR

110 НАГРАДИ ЗА ГРАЃАНСКО НОВИНАРСТВО | SHIRËVLIME PËR GAZETARI QYTETARE

1000+ УЧЕСНИЧКИ И УЧЕСНИЦИ НА СЕМИНАРИ И РАБОТИЛНИЦИ | PIESËMARRËSE DHE PIESËMARRËS NË SEMINARE DHE PUNËTORI



ОДА • GENDER PER LIRI • CENTER FOR FREEDOM



ТРОП
ТРО
S COM

CIVIL
National Endowment
for Democracy

CIVIC LENSES PROJECT

www.civil.org.mk

ОДНОСТАНИЧКИ СЕМИНАР КИЕВ
ИЗБОРНИ ПРОЦЕСИ И РЕЗУЛТАТИ
ДИСКРИМИНАЦИОНАЛНОСТ
КРИШЕ НА ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА
СОВЕТСКИ ДА НАПРАВИШ ПРОМЕНА
СВОЕТО КИНО, ПАРОЛТО



CIVIL

WWW.CIVIL.ORG.MK

HUMAN RIGHTS
SUSTAINABLE
FREE SOCIETY
CITIZEN ELECTIONS
PARTICIPATION
SOCIAL JUSTICE
ARMS CONTROL

free it's your right

PLATFORM
www.civil.org.mk
encivil.mk
mk

NDRYSHIMI ËSHTË NË DUART TUAJA

QYTETARE(Ë)T MARRIN PJESË, VËZHGOJNË, RAPORTOJNË

OBJEKTIVI QYTETAR

PROJEKT PËR PROMOVIMIN E TRANSPARENCËS DHE PËRGJEGJËSISË NË PROCESET POLITIKE

CIVIL, 2019

NDRYSHIMI ËSHTË NË DUART TUAJA

QYTETARE(Ë)T MARRIN PJESË, VËZHGOJNË, RAPORTOJNË

Publikim i projektit:

OBJEKTIVI QYTETAR – PROJEKT PËR PROMOVIMIN E TRANSPARENCËS
DHE PËRGJEGJËSISË NË PROCESET POLITIKE

Botues: CIVIL-Qendra për Liri

Për Botuesin: Xhabir M. Deralla

Redaksia:

Xhabir M. Deralla, Biljana Jordanovska, Sinisha Stankoviq, Maja Ivanovska,
Igor Ilievski, Dijana Tahiri, Dehran Muratov, Angella Petrovska, Arian
Mehmeti, Simona Maneva Zhivkova, Arben Zeqiri, Atanas Petrovski

Layout&Design: Xhabir M. Deralla, Arian Mehmeti

Redaksia gjuhësore: Natasha Cvetkovska, Dijana Tahiri, Gordana Aceska

Ky publikim është i financuar nga fondacioni National Endowment for
Democracy.

**Gjetjet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë publikim janë vetëm të
CIVILit dhe të autore(ë)ve dhe nuk i pasqyrojnë domosdoshëm qëndrimet
e donatorit.**

Kontakte:

CIVIL, Maksim Gorki31/1, Shkup, Republika e Maqedonisë

02/5209176/| civil@civil.org.mk | civil.macedonia@gmail.com

WWW.CLP.MK

PËRMBAJTJA | 5 Ekipi i CIVILit për komunikime Shënime hyrëse : NDRYSHIMI ËSHTË NË DUART TUA-JA! | **9** Xhabir Deralla Lufta për shoqëri të lirë dhe demokratike| **17** Sinisha Stankoviq GAZETARIA QYTETARE - FILTËR PËR SHOQËRI MË TË SHËNDOSHË | **29** Sasho Ordanoski Gazetaria qytetare do ta dënojë gazetar-inë profesionale | **35** Igor K. Ilievski Nga “vinçat” në “boshte” - lajmet të rreme midis etikës dhe gjobave | **43** Zoran Ivanov Gazetaria qytetare Ivanov është çështje dinamike që e modelon politikën **54** Petrit Saraçini Gazetaria qytetare është përgjigje e mungesës së informatave të besueshme dhe të pavarura **58** Jasna Bačovska A KEMI NDJENJË SE VENDOSIM NË KËTË SHOQËRI ? | **62** Arben Zeqiri Gazetarët qytetarë kon-tribujnë në të gjitha sferat sociale, veçanërisht në nivelin lokal | **64** Merita Maksuti QYTETARI ËSHTË VETËM RETORIKË, E JO QËLLIM I NDRYSHIMEVE SHOQËRORE | **67** Biljana Ivanovska në lidhje me luftën kundër korrupsionit, PJESMARRJA E QYTETARËVE ËSHTË VENDOSËSE | **74** Biljana Jordanovska Pjesëmarrja qyte-tarE, një hap drejt një shoqërie të vërtetë demokratike **78** Maja Ivanovska Transparenca dhe përgjegjësia janë një detyrim i përcaktuar qartë, abuzimi i pozicionit zyrtar gjatë zgjedhjeve është rreptësisht i ndaluar Goran Trajkov Gazetaria qytetare është një mjet për të trajtuar problemet sociale! | **84** Simona Maneva Zhivkova Gazetaria qytetare është një mjet i fuqishëm për të ndikuar institucionet dhe pushtetin **86** Shënimi i mbylljes GAZETARIA QYTETARE ËSHTË NË LINJAT E PARA TË FRONTIT.



W

CIVIL
www.civil.org.mk
HUMAN RIGHTS
SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
FREE SOCIETY
CITIZEN
PARTICIPATION
SOCIAL JUSTICE

**CIVIC
LENSES
PROJECT**
www.civil.org.mk

NDRYSHIMI ËSHTË NË DUART TUAJA!

Në këtë publikim, ekipi i CIVILit që e zbaton projektin “Objektivi qytetar – promovimi i transparencës dhe përgjegjësisë në proceset politike” ka zgjedhur tekste relevante në temat me të cilat merret projekti. Dominojnë tekstet për lajmet e rrejshme dhe gjuhën e urrejtjes, por transparencë dhe përgjegjësi në proceset politike, patjetër, është në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e vazhdueshme, transversale në pjesën më të madhe të përmbajtjeve që prodhohen në projektin, si dhe në këtë publikim.

Kjo është një përmbledhje e llojit e teksteve të ndryshme që mund të shërbejnë si materie edukative dhe nxitje për njerëzit që punojnë në organizatat e shoqërisë qytetare, mediat, universitetet, por edhe më gjerë, për të gjithë qytetarët dhe qytetarët. Njëkohësisht, ky publikim paraqet një udhërrëfyes të shkurtuar nëpër temat me të cilat merret CIVILi gjatë zbatimit të projektit “Objektivi

**NË PERIUDHA TË
TURBULLIRAVE
POLITIKE, KUR NË
KOMUNIKIMIN PUB-
LIK SHPESHTOHET
PËRDORIMI I GJUHËS
SË URREJTJES DHE
LAJMEVE TË RRE-
JSHME, GAZETARE(Ë)
T QYTETARË JANË
ATA TË CILËT MUND
TË KONTRIBUOJNË
PËR ANGAZHIMET
SHOQËRORE PËR
DEBAT PUBLIK TË
ARGUMENTUAR,
PËR SHPALOSJEN E
DEZINFORMATAVE,
LAJMEVE TË RRE-
JSHME DHE GJUHËN
E URREJTJES.**

qytetar”.

Njëkohësisht, ky publikim paraqet vazhdimësi të tre publikimeve paraprake me titull, të përbashkët “Ne jemi mediat” të cilat i publikoi CIVILi nga viti 2016 deri në vitin 2018.

CIVILi u bën thirrje të gjithë qytetarëve të fotografojnë, incizojnë dhe të shkruajnë raporte për atë që ndodh në mjedisin e tyre, në punë, në fqinjësi, në komunikime, në kontaktin me institucionet. Vetëm me pjesëmarrjen qytetare dhe informimin qytetar nga terreni, shoqëria do të arrijë të merret suksesshëm me klientelizmin dhe korrupsionin. Pjesëmarrja qytetare në çdo segment të jetës shoqërore dhe politike është zgjedhja e vetme për një shoqëri të integruar dhe të qëndrueshme, pa paragjykime, pa dhunë, pa keqpërdorime dhe pa korrupsion.

Ndryshimi është në duart tuaja! – klith CIVILi nga fillimi i projektit në tetor të vitit 2015.

Si dhe shumë herë më parë, ekipi i CIVILit, do ta shfrytëzojë edhe këtë rast t' bënë thirrje lexueseve dhe lexuesve të këtij publikimi t'i ndajnë këto përmbajtje me mikeshat dhe miqtë e tyre. Ky publikim është i karakterit të hapur. Shkruani faqe të reja në të. Mbajeni objektivin tuaj çdo herë të gatshëm për kapjen dhe

**AKTIVIZMI DHE SHO-
QËRIA QYTETARE,
JANË MES MJETEVE
MË TË SUKSESSHME
ME TË CILAT QYTE-
TARET DHE QYTET-
ARËT KANË MUNDËSI
TË JENË KONTROL-
LUES TË PUNËS SË
FUNKSIONARËVE
SHTETËRORË DHE
LOKALË, NË MËNYRË
TRANSPARENTE DHE
PËRGJEGJËSE.**

përhapjen e të vërtetës! Ne jemi mediat!

Ekipi i CIVILit për komunikim



Objektivi qytetar është projekt për procese transparente dhe përgjegjëse politike, përmes mbështetjes dhe popullarizimit të gazetarisë qytetare, forcimit të vetëdijes publike, edukimit qytetar dhe aktivizmit të qytetareve dhe qytetarëve për të drejtat e njeriut, demokracisë dhe zgjedhjeve të lira.

Ky është projekt që siguron trajnim dhe mundësi për pjesëmarrje, vëzhgim dhe raportim të qytetarëve për ngjarjet politike dhe shoqërore dhe proceset duke i përfshirë edhe zgjedhjet.

Përmes **Objektivit qytetar**, qytetaret dhe qytetarët i përkujtojnë autoritetet dhe funksionarët për obligimin e tyre të jenë transparentë dhe përgjegjës.

NË LUFTË PËR SHOQËRI TË LIRË DHE DEMOKRATIKE

XHABIR DERALLA

Popullizëm, nacionalizëm, urrejtje etnike dhe fetare, propagandë kundër perëndimit, lajme të rrejshme dhe dezinformata, gjuhë e urrejtjes, dhunë mbi gratë dhe LGBTI komunitetet, ekskludim, fushatë kundër migrantëve, promovim i pasurisë dhe fuqisë dhe dialogut – janë tendenca dhe ide të promovuara haptazi dhe në mënyrë agresive pikërisht përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

DEMOKRACIA ËSHTË NË KRIZË.

Pa pretendime të bëhen analiza me kilometra të gjendjeve me lirinë e shprehjes dhe lirive të mediave, aktivizmit dhe gazetarisë qytetare, ky shkrim ka për qëllim vetëm të jep udhëzim për temat kryesore që janë të lidhura me ngjarjet më të reja në këto fusha, të shoqëruara me disa sinjale paralajmëruese.

Në këtë kuptim, kjo është një përpjekje për të vendosur disa udhëzime për zhvillimin e ideve përparimtare që kontribuojnë në forcimin e rezistencës dhe luftës kundër autoritarizmit, nacionalizmit dhe tendencat diskriminuese në shoqëri. Raporti i Freedom House thotë: Në vitin 2018, raporti "Liria në botë" shënon vitin e 13 radhazi të rënies së lirisë globale. Kthesa përfshin vende të ndryshme në secilin rajon, nga demokracitë shumëvjeçare si Shtetet e Bashkuara deri te regjimet e konsoliduara autoritare si Kina dhe Rusia. Humbjet e përgjithshme janë akoma më të vogla në krahasim me përfitimet e fundvitit të 20-të, por modeli është konsistent dhe me qëllim të keq. Demokracia është në krizë. Në përpjekje për të zbuluar se ku janë rreziqet kryesore, së paku sa i përket rajonit ballkanik, situata është shqetësuese pikërisht në domenin e industrisë së medias. Mediat janë shënjestra kryesore e regjimeve autoritare dhe strukturave politike që janë në rritje dhe që i rrezikojnë themelet e institucioneve demokratike në shumë vende, duke i përfshirë edhe shoqërinë dhe shtetin maqedonas. Popullizëm, nacionalizëm, urrejtje etnike dhe fetare,

"MBUROJA" MË E SHPESHTË QË E PËRDORIN GJENERATORËT DHE ZBATUESIT E KËTYRE IDEVE TË PRAPAMBETURA DHE LËVIZJEVE SOCIOPOLITIKE ËSHTË, NË FAKT, LIRIA E SHPREHJES

propagandë kundër perëndimit, lajme të rrejshme dhe dezinformata, gjuhë e urrejtjes, dhunë mbi gratë dhe komunitetet LGBTI, ekskluzion, fushatë kundër migrantëve, promovim i pasurisë dhe fuqisë së dominimit kundrejt koncepteve – drejtësia sociale dhe dialogu – janë tendenca dhe ide haptazi dhe me agresivitet të promovuara përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

"Mburoja" më e shpeshtë që e përdorin gjeneratorët dhe zbatuesit e këtyre ideve të prapambetura dhe lëvizjeve sociopolitike është, në fakt, liria e shprehjes. Kështu të mbrojtur me "liri të shprehjes", strukturat autoritare dhe shpesh kriminele, të organizuara në parti politike dhe fondacione, lehtë hyjnë dhe shpesh dominojnë në diskursin publik, në numër shqetësues të rritjes së shoqërive, duke e përfshirë edhe Evropën. Veçanërisht e ndjeshme është shoqëria e Maqedonisë e cila është në proces të transformimit demokratik të shoqërisë dhe institucioneve shtetërore, pas një dekade shteti të robëruar në periudhën 2005 – 2016.

Për më keq, propaganda nuk i sulmon vetëm themelet e lirisë dhe demokracisë, duke i përdorur terminët "liri" dhe "demokraci" si mjete dhe mesazhe (mburojë), por, ajo është shumë e suksesshme në dekurajimin e pjesëmarrjes qytetare dhe vetëdijes qytetare. Më saktë, ky lloj i propagandës punonte

**PËR MË KEQ, PROP-
AGANDA NUK I
SULMON VETËM
THEMELET E LIRISË
DHE DEMOKRACISË,
DUKE I PËRDORUR
TERMINËT "LIRI"
DHE "DEMOKRACI" SI
MJETE DHE MESAZHE
(MBURJË), POR,
AJO ËSHTË SHUMË
E SUKSESSHME
NË DEKURAJIMIN
E PJESËMARRJES
QYTETARE DHE
VETËDIJES QYTET-
ARE.**

zellshëm për "mbytjen" e shpresës së njerëzve. Sot, ekziston qëndrim i zgjeruar se "të gjithë janë të njëjtë" dhe "asgjë nuk mund të ndryshohet". Paralelisht me këtë, popullistët dhe simpatizuesit e autoritarizmit me sukses i morën dhe e riciklojnë më të mirën nga aktivizmi pro-demokratik anëmbanë botës, duke e shfrytëzuar – kundër demokracisë!

Shoqëria qytetare, mediat dhe lëvizjet qytetare pro-demokratike ishin shënjestër, kështu që të ata janë të infiltruar radikalët, ndërsa pjesërisht edhe u rikomponuan. Vërehet se në disa vitet e kaluara u zbatuan aktivitete komplekse propagandiste, që rezultoi në gjendje në të cilën shumë të rinj tani protestojnë në shërbim të strukturave radikale, populliste dhe autoritare, pa pasur vetëdije. Stili rus i luftës hibride kundër demokracisë, pjesërisht arritën t'i manipulojnë njerëzit, duke përdorur pasqyrë të shtrembëruar për atë që paraqet liria dhe demokracia, ndërsa pjesërisht pasivizoi pjesë nga rinia paraprakisht aktive dhe popullatën e përgjithshme.

Me fjalë tjera, lajmet e rrejshme dhe dezinformatat u shndërruan në pjesë përbërëse të maintstream-it publik, duke i vendosur në kornizë faktet në kontekste që çojnë deri në përfitime politike dhe tjera (edhe më përfituese) për grupet dhe strukturat autoritare dhe nacionaliste në shoqëri. Shënjestra tjera, bara-

**ME FJALË TJERA,
LAJMET E RREJSHME
DHE DEZINFORMATAT U
SHNDËRRUAN NË PJESE
PËRBËRËSE TË MAINTS-
REAM-IT PUBLIK, DUKE I
VENDOSUR NË KORNIZË
FAKTET NË KONTEK-
STE QË ÇOJNË DERI NË
PËRFITIME POLITIKE DHE
TJERA**

bartë të penetruara janë institucionet, veçanërisht gjyqësori, nga i cili korrupsioni në asnjë mënyrë nuk po çrrënjohet.

Gazetaria qytetare, njëherë mjet i aktivistëve për të drejtat e njeriut dhe organizatave në shoqërinë maqedonase, është pjesërisht e miratuar dhe e rikomponuar (dhe e korruptuar) për nevojat e propagandës kundër perëndimit



në vend, shumë fleksibile dhe e komplikuar, e bazuar mbi vjedhjen e ideve dhe mesazheve dhe që janë të manipuluar deri në nivel të të panjohurës. Kombinimi i mesazheve “të gjithë janë të njëjtë”, imazhi i modernizuar i #huazuar# nga Revolucioni i Larmë (2016) dhe lajmet e rrejshme shfrytëzohen nga ana e kundërshtarëve të aspiratave maqedonase për hyrje në NATO dhe BE, dhe

KOMBINIMI I ME-SAZHEVE "TË GJITHË JANË TË NJËJTË", IMAZHI I MODERNIZUAR I #HUAZUAR# NGA REVOLUCIONI I LARMË (2016) DHE LAJMET E RREJSHME SHFRYTËZOHEN NGA ANA E KUNDËRSHTARËVE TË ASPIRATAVE MAQEDONASE PËR HYRJE NË NATO DHE BE

është në favor të një politike shumë të dhunshme, nacionaliste dhe izoluese të regjimit autoritar në vend (2006 – 2016).

Të përfundojmë... Fundi i viteve 2010 është i shënuar me lëvizje dramatike të ideologjive të prapambetura drejt metodave më të sofistikuara të manipulimit me opinionin publik. Liria e shprehjes keqpërdoret në favor të tendencave anti demokratike dhe kundër -perëndimore. Sulmet hibride mbi demokracinë manifestohen përmes fushatave të vazhdueshme dhe agresive me lajme të rrejshme dhe gjuhë të urrejtjes. Aktivizmi dhe gazetaria qytetare janë të kidnapuara si grup i ri-dizajnuar për propagandë nacionaliste dhe kundër-perëndimore. Një numër i madh i të rinjve dhe popullata e përgjithshme u pasivizuan me mesazhet " të gjithë janë të njëjtë" dhe "asgjë nuk mund të ndryshojë".

Ajo që na duhet është që përsëri t'i mobilizojmë qytetaret dhe qytetarët e rinj progresivë në përgjithësi, dhe të nxisim ta kthejnë pozitën e tyre të pjesëmarrjes aktive në proceset e vendimmarrjes dhe të jenë të vetëdijshëm për sfidat e reja që i bart lufta hibride kundër demokracisë. Pra...

Fundi është larg. Ky është vetëm fillimi i një beteje të re të gjatë për shoqëri të lirë dhe demokratike. Kemi fakte, i dimë përgjigjet. Ajo që duhet tani, është të

**SULMET HIBRIDE
MBI DEMOKRACINË
MANIFESTOHEN
PËRMES FUSHATAVE
TË VAZHDUESHME
DHE AGRESIVE ME
LAJME TË RREJSHME
DHE GJUHË TË URRE-
JTJES.**

marrim masa urgjente për ripërtrirjen e rezistencës kundër valës së autoritarizmit dhe ta ngadhënjejmë.



GAZETARIA QYTETARE – FILTËR PËR SHOQËRI MË TË SHËNDOSHË

SINISHA STANKOVIQ

Nëse e keni mirë, atëherë asgjë....

Kur e filluam projektin “Objektivi qytetar”, aforizmi “Edhe në hënë edhe në Maqedoni – nuk ka jetë”, më së miri e pasqyronte gjendjen, dhe desha të provoj, aq sa di dhe jam i aftë: shumë “trpe-trajçe-mirçe -spas-et”, të vetëdijësohen për gjendjen deri te cila kemi arriutr dhe të klithin zëshëm kundër padrejtësive dhe krimit që e mbytën shtetin.

Në një nga intervistat që kam pasur me poetin e madh, (por mbi të gjitha, i mrekullueshëm) (person) Mihail Renxhov, ai, në një mënyrë poetike, kujtoi edhe momentet kur, në grevën e parë të madhe të punëtorëve në Shkritoren e Shkupit, diku në fund të tetëdhjetave të shekullit të kaluar, "Trpe", "Trajçe" dhe "Spase", sipas tij, të bëhen "Glase"... Ndër kujtimet për atë klithje krenarie të tij, vërehej edhe dëshira e perealizuar – banori mesatar i Maqedonisë më në fund të krijojë shoqëri të hapur dhe demokratike dhe shtet ligjor, në të cilin të gjithë qytetarët do të jetojnë të barabartë...

Kur pranova të marr pjesë në projektin "Objektivi qytetar" të CIVIL -Qendrës për Liri, para katër vitesh, aforizmi "Edhe në hënë edhe në Maqedoni – nuk ka jetë", më së miri e pasqyronte gjendjen, dhe desha të provoj, aq sa di dhe jam i aftë: shumë "trpe-trajçe-mirçe -spaset", të vetëdijesohen për gjendjen në të cilën kemi arritur dhe zëshëm të reagojnë kundër padrejtësive dhe krimit që e mbytën shtetin.

Edhe pse e dija se bëhet fjalë edhe për tentim për tejkalimin e "kontaminimeve" shekullore me thëniet sipas të cilave "Kokën e ulur nuk e pret shpata", dhe "këshillat", madje edhe para varjes, se më mirë është "të heshtet, se çdo herë mund të jetë edhe më keq", në projektin gjeta mundësi për ndryshim. Anekdodat për mentalitetin, për të cilin viktimat pyet nëse xhelati ka litarin e tij që ta varë, ose ajo vetë, të shkojë deri në shtëpi dhe të sjell litar 9 e atje, në shtëpi, nën dysheme, bashkë me paranë e fundit, i ruan për "ditë të zeza" edhe kuburen edhe thikën, të cilat puthen në video -spote dhe filma revolucionar), asnjërin më nuk e bëjnë të qesh... Por fakt është se banorët e Maqedonisë

**NGA ANA TJETËR, SI
FSHEHJE TË KRIMIT,
THUAJSE NJË DEKADË
NË MËNYRË PARALELE
KRIJOHEJ HISTERI E
KUAZI-PATRIOTIZMIT
(DY GOTA RAKI DHE DO
TË VDESIM PËR MAQEDON-
DONI!), TË PERSEKU-
TIMIT TË SHTRIGAVE
("TRADHTARË" DHE
"SPIUNË" NË FAKT
TË GJITHË QË MEN-
DOJNË NDRYSHE),
TË FORMIMIT TË
IDENTITETIT TË RI
NACIONAL...**



*Punëtori për gazetari
qytetare gjatë CIVIL
festit, Shkup, 11 dhjetor
2018*

me shekuj janë bindur se më mirë është të qëndrohet urtë, madje edhe në këngë, Maqedonasi vetes i drejtohet me deminutiv, që mos t'i hidhërojë krijuesit e fatit të tij... Të mos trazohet, të durohet, të shpëtohet..., janë këshilla të bartura nga brezi në brez, të cilat, për fat të keq, e kanë thyer shpirtin dhe e kanë formuar mentalitetin skllavëror.

Nga ana tjetër, si fshehje të krimit, thuajse një dekadë në mënyrë paralele kri-

**SINGERISHT, NUK
E MBAJ MEND SE
SA SEMINARE DHE
PUNËTORI KEMI MBA-
JTUR NË QYTETET
NËPËR MAQEDONI,
NË PALLATE TË KUL-
TURËS, HOTELE, IN-
STITUCIONE RINORE,
POR EDHE JASHTË,
NË PARQE, SHESHE...**

johej histeri e kuazi-patriotizmit (dy gota raki dhe do të vdesim për Maqedoni!), të persekutimit të shtrigave ("tradhtarë" dhe "spiunë" në fakt të gjithë QË MENDOJNË NDRYSHE), të formimit të identitetit të ri nacional... Dhe për këto arsye, përskaj video aktivizmit qytetar, me dekada aktual në botë, në kaosin që sundonte në Maqedoni, si dhe për shkak të karakteristikës – "ku rafsha mos u vrafsha", isha skeptik për suksesin e idesë për gazetari qytetare.

Singerisht, nuk e mbaj mend se sa seminare dhe punëtori kemi mbajtur në qytetet nëpër Maqedoni, në pallate të kulturës, hotele, institucione rinore, por edhe jashtë, në parqe, sheshe... Natyrisht, nuk i mbaj mend as fytyrat e qindra pjesëmarrësve, edhe pse me disa nga ata kemi debatuar dhe jemi shoqëruar për mrekulli. Por, e di se CIVILI ka ndarë mbi 100 shpërblime për artikujt më të mirë të gazetarëve qytetarë, studentëve, të papunësuarve, të falimentuarve, tepricave teknologjike, pensionistëve, por edhe gazetarëve profesionalë, të pakënaqur nga gjendja në mediat – megafonë të pushtetit... Megjithatë, para së gjithash janë "njerëz të rëndomtë, të cilët në numër të madh, asnjëherë as që kanë menduar se ndonjëherë do të fotografojnë, incizojnë video artikuj ose informojnë për ndonjë ngjarje.

Mobilizoheshin qytetarë "nga fqinjësia", ata të cilët ndoshta as lajmet, as

MOBILIZOHESHIN QYTETARË "NGA FQINJËSIA", ATA TË CILËT NDOSHTA AS LAJMET, AS MEDIAT TRADICIONALE NUK I KANË INTERESUAR AQ, DERISA NUK I KA GJETUR NDONJË PADREJTËSI DHE NUK KANË MARRË GUXIMIN TË FLASIN PËR KËTË, DUKE KONSIDERUAR SE NUK KANË SE ÇFARË TË HUMBIN...

mediat tradicionale nuk i kanë interesuar aq, derisa nuk i ka gjetur ndonjë padrejtësi dhe nuk kanë marrë guximin të flasin për këtë, duke konsideruar se nuk kanë se çfarë të humbin... Po, një pjesë e mirë e të shpërblyerve, akoma dëshironin të mbeten anonimë për opinionin e gjerë, por projekti për gazetari qytetare, megjithatë e plotësoi qëllimin.

Ndërsa qëllimi ishte edukimi për të drejtat e njeriut në kuptimin më të gjerë dhe kyçje të sa më tepër qytetarëve, të vetëdijshëm për të drejtat dhe obligimet e tyre, në proceset e vendimmarrjeve në nivel lokal dhe qendror. Sipas rregullave të qarta dhe të shkurta: 1 – Mos e bëj atë që nuk dëshiron të ta bëjnë, dhe 2. – Nuk pajtohem me pretendimin Tuaj dhe do ta kundërshtoj me qëndrime të kundërta të argumentuara, por çdo herë do të luftoj për të drejtën tuaj ta shprehni lirë mendimin tuaj. Dhe aq.

Derisa të arrijmë deri te niveli në të cilin etika dhe morali i bartësve të funksioneve publike do të jetë pjesë përbërëse e personalitetit të tyre, ndërsa nuk do të "zgjohen" vetëm nën presionin e publikut, ose kur të zihen me duart në mjaltë. Dhe derisa frika dhe përulësia nuk i lënë vend kritikës dhe vendosjes së interesit të përgjithshëm para interesit personal, ndërsa standardet dhe kriteret e vlerave nuk diferencohen...Që të kemi publik të zgjuar, çdo herë të

NË “OBJEKTIVIN QYTETAR” I PËRZIENIM HULUMTIMIN, AKTIVIZMIN DHE PUNËN MEDIATIKE PËRMES PORTALEVE NË DISA GJUHË TË CIVIL MEDIA DHE FAQES SË SPECIALIZUAR TË PROJEKTIT WWW.CLP.MK.



Ekipi i CIVILIT xhiron, foto-grafon, iterviston...Imazh i shpeshtë nëpër tërë vendin. (Shkup, 8 Shkurt 2019)

gatshme të reagojë, dhe të ketë media të hapura me gazetarë profesionistë, me redaktorë – mbrojtës të nderit dhe dinjitetit të profesionit dhe me pronarë të përgjegjshëm shoqërorë...

Në “Objektivin qytetar” i përziem hulumtimin, aktivizmin dhe punën media-tike përmes portaleve në disa gjuhë të CIVIL Media dhe faqes së specializuar të projektit www.clp.mk. U përpoqëm ti motivojmë qytetarët të jenë vrojtues aktivë të të gjitha sferave të shoqërisë, të praktikumit të politikës në çdo nivel, të keqpërdorimeve, manipulimeve zgjedhore dhe të gjitha pengesave të shtetit ligjor -përmes korrupsionit, nepotizmit, partizimit të plotë të jetës së

**DËSHIRONIM EDHE,
AQ SA ËSHTË E MUN-
DUR, TA FORCOJMË
VETËDIJEN PUBLIKE
DHE TA NXISIM PRO-
CESIN E PJEKURISË
SË SHOQËRISË
MAQEDONASE.**

përditshme...

Dëshironim edhe, aq sa është e mundur, ta forcojmë vetëdijen publike dhe ta nxisim procesin e pjekurisë së shoqërisë maqedonase. Në valën e protestave të nxënësve të shkollave të mesme, studentëve, ekologëve dhe “park-mbrojtësve”, honoraristëve (gazetarë, shkrimtarë, piktorë, arkitektë, përkthyes...) revolucionarët e larmë nga rrugët anembanë Maqedonisë, dhe gazetarët qytetarë, e fituan vendin e tyre.

Si korrigjues, posaçërisht në nivel lokal – secili në komunitetin e vet, lagje, fshat...

Provuam edhe të ndihmojmë në ngritjen e nivelit të shkrim – leximit medi- atik të M. T. Konsumentit të përmbajtjeve mediatike, që për më tepër se një dekadë ishte i helmuar me spine dhe gënjeshtra, që të mundet t’i njohë lajmet e rrejtshme, diskriminimin, gjuhën e urrejtjes...

Por, edhe ngritjen e shkrim -leximit mediatik dhe shkrim-leximin e përgjith- shëm edhe te një pjesë e gazetarëve profesionalë, të cilët, të lënë në mëshirën e biznes elitave lakmitare dhe të azdisura që bëni presion edhe mbi një pjesë të pronarëve të korruptuar të mediave dhe mbi redaktorët me shpinë elastike, thjeshtë, nuk dinin se mundet edhe ndryshe. Edhe, se atë që e bëjnë për çdo

**NËPËR SEMINARE
SHPESH FLASIM PËR
ZANATIN GAZETAR,
PARA SË GJITHASH,
PËR NDERSHMËRINË,
MORALIN, PËRKUSH-
TIMIN, RESPEKTIMIN
E STANDARDEVE,
INFORMIMIN E DO-
MOSDOSHËM...**

ditë, nuk ka lidhje me profesionin fisnik – gazetarinë.

Prandaj, në seminarët dhe punëtoritë, përsëri “teknikës” (udhëzimet për përdorimin e “telefonave të mençur), fotoaparateve, kamerave... mënyrat e dërgimit të materialeve të incizuara dhe publikimi i tyre në internet, si dhe rregullat themelore për lajmin si mbretëreshë e gazetarisë dhe për piramidën e përmbysur me pyetjet e njohura (5W + 1H), shpesh flasim për zanatin gazetar, para së gjithash, për ndershmërinë, moralin, përkushtimin, respektimin e standardeve, informimin e domosdoshëm...

Asnjëherë nuk kam konsideruar se gazetaria qytetare duhet të jetë alternativa e vetme e mediave tradicionale, as se gazetarët qytetarë duhet t'ua shpëtojnë profesionin gazetarëve në Maqedoni, të cilët vetëm, në mënyrë esnafë duhej dhe duhet të merren me furacakët (pakurrizorët ose të paguarit) në radhët e tyre.

Por, në situatë në të cilën gazetaria profesionale në Maqedoni është i sëmuri rëndë, çdo ilaç është i mirëseardhur, ndërsa çdo injektim nga aktivistët, qytetarët e vetëdijshëm, ja edhe në rolin e gazetarëve, mund vetëm të ndihmojë. Posaçërisht që edhe përsëri pretendimeve të caktuara se më në fund “erdhi jeta”, ende nuk jam i sigurt.

POR, NË SITUATË NË TË CILËN GAZETARIA PROFESIONALE NË MAQEDONI ËSHTË I SËMURI RËNDË, ÇDO ILAÇ ËSHTË I MIRË-SEARDHUR, NDËRSA ÇDO INJEKTIM NGA AKTIVISTËT, QYTETARËT E VETËDIJSHËM, JA EDHE NË ROLIN E GAZETARËVE, MUND VETËM TË NDIHMOJË.

Nuk kam qenë në Hënë...





Даниел Јошески

13 min · 🇲К

ВО АВТОБУС 63 СЕ СЛУЧИ СЕРИОЗЕН ИНЦИДЕНТ ВЛЕГОА 30 АЛБАНЦИ ШВЕРЦЕРИ И ГИ ТЕПАА СИТЕ ПАТНИЦИ ГО КРШЕА АВТОБУСОТ ГИ ПЦУЕЈА МАКЕДОНЦИТЕ, ОЛИВЕР СПАСОВСКИ ШТО СЕ СЛУЧУВА НЕМОЈ ДА СЕ ОБИДЕШ ОВА ДА ГО СОКРИЕШ ОВА Е СЕРИОЗЕН ИНЦИДЕНТ ИМА ПОВРЕДЕНИ ПАТНИЦИ!!!

Baily we
don't need
you!!!
go home!

NGA LAJMET E RREJSHME DHE GJUHA E URREJTJES DERI TE SULMI I PËRGJAKSHËM NË KUVEND



BuBe Risteski Бел ден да не видите. Семето да ви се сотре.



1



Bistra Mitik Grom da ve utepa kako so si odete gubrina



2



Zoran Janevski Да ци се сотре семката до седмо колено предавници



2



Petar Miovski U usta da ve ebam i vas i razum i dialog ima edna vistina ima edna MAKEDONIJA !



2



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 prill 2017

Gazetaret dhe gazetarët qytetarë

Kontribuojnë për krijimin e mediave të lira dhe të pavarura dhe angazhohen për politika transparente dhe përgjegjëse për vendin. Pasi CIVILI e vendosi gazetarinë qytetare në vëzhgimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe zgjedhjet, opinioni është i alarmuar, si dhe shkelësit e ligjit. Shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk është më e padukshme – opinioni për këtë mund të informohet menjëherë, përmes artikujve të gazetarëve qytetarë.

GAZETARIA QYTETARE DO T'I JEP FUNDIN GAZETARISË PROFESIONALE

Analisti politik dhe profesori d-r Sasho Ordanoski flet për gazetarinë qytetare dhe për atë nëse dhe sa ky lloj i gazetarisë mund të kontribuojë për procese më transparente dhe përgjegjëse.

Sot është iluzore të flitet për ose kundër gazetarinë qytetare sepse të gjithë ne në xhepat mbajmë nga një studio televizioni.

**Ë PARIM, KUR SË-
MURENI, NUK SHKO-
NI TE MJEKU QYTE-
TAR, POR SHKONI
TE MJEKU QË KA
KRYER FAKULTETIN E
MJEKËSISË.**

Në mungesë të terminit më të mirë, ajo që sot ndodh ne e quajmë gazetari qytetare. Përndryshe, kjo nuk ka lidhje me gazetari. Në parim, kur së-mureni, nuk shkoni te mjeku qytetar, por shkoni te mjeku që ka kryer fakultetin e mjekësisë. Sepse zanati, si në profesionin e mjekësisë, ashtu edhe në gaze-tari, është i rëndësishëm.

Mirëpo, sot është iluzore të flitet për ose kundër gazetarinë qytetare për arsyen se të gjithë ne në xhepat tonë mbajmë nga një studio televizive. Problemi është se gazetaria ka standarde të ashpra të cilat duhet të mësohen. Gazetaria është profesion që nuk është shkencë, por është zanat që duhet ditur. Kur ato standarde dhe rregulla zanati nuk njihen, atëherë kemi një kakofoni totale, e cila shpërndahet në mediat sociale dhe e cila shpesh i bën dëm demokracisë, në vend se të ndihmojë.

Prandaj ne sot merremi me atë se kush në cilën kafene e kalon kohën, me gjendjen e llogarisë fiskale kur është ngritur nga vendi pasi i ka ngrënë kikirikët dhe për këtë ka 300.00 pëlqime dhe nuk e di se sa dukshmëri në rrjetet sociale, ndërsa debati serioz për reformën në arsim ka 3000 shikues. Njerëzit e humbën interesin për kontekstin, sepse kjo, e ashtuquajtur – gaze-tari qytetare nuk merret me kontekstin, që është thelbi i profesionit gazetar,

СЛОБОДНИ МЕДИУМИ
ЗА СЛОБОДНО ОПШТЕСТВО
СЛОБОДНО. НЕЗАВИСНО. ОТВОРЕНО

MEDIA TË LIRA
PËR SHOQËRI TË LIRË
LIRË. PAVARUR. HAPUR



CIVILMEDIA

FREI. UNABHÄNGIG. OFFEN
FREE. INDEPENDENT. OPEN

www.civil.org.mk



**KEMI ARRITUR DERI
TE FAKTI SE GJEN-
ERATAT E REJA JO
VETËM SE NUK E
KËRKOJNË KONTEK-
STIN TË SHIHET EDHE
ANA TJETËR, POR
KËRKOHEM FOTO-
GRAFI QË TË SHIHET
NJË ILUSTRIM PËR
DIÇKA QË KA NDOD-
HUR, NDËRKAQ E CILA
NUK TREGON ASGJË
PËR RRETHANAT NË
TË CILAT KA NDOD-
HUR.**

por merret me shpejtësinë e plasimit të "lajmit". Kemi arritur deri te fakti se gjeneratat e reja jo vetëm se nuk e kërkojnë kontekstin të shihet edhe ana tjetër, por kërkohet fotografi që të shihet një ilustrim për diçka që ka ndodhur, ndërkaq e cila nuk tregon asgjë për rrethanat në të cilat ka ndodhur.

Pyetja se çfarë mendoj unë për gazetarinë qytetare është e pakuptimtë, kjo nuk është gazetari, por është diçka që ndodh, diçka që nuk mund të anashkalohet. Diçka për të cilën jam i sigurt që do të ketë pasoja mbi gazetarinë qytetare. Sepse njerëzit më nuk kanë as kohë, as nevojë të merren me kontekstet, ndërsa thelbi i profesionit gazetar është të shpjegohen kontekstet e fotografive që i shihni.

Mendoj se për këtë shkak gazetaria është profesion në zhdukje dhe është kontestuese edhe sa vite mund të mbijetojë. Nga njëra anë do të mësohemi në këtë frekuencë jashtëzakonisht të madhe të pakuptimësive, të humbjes së kohës... Pastaj, ka edhe një karakteristikë plotësuese që do të thotë se di të humbet përgjegjësia rreth asaj që bisedohet dhe si bisedohet për ngjarje të caktuara. Ky me siguri se është standardi i si me të cilin ditë e më tepër mësohemi. Kjo pastaj do të reflektohet mbi krijimin e politikës. Sepse edhe

**SEPSE EDHE POLITIKA
NUK ËSHTË E PAAFTË.
AJO DO TË FILLOJË
TI MANIPULOJË KËTA
GAZETARË QYTETARË
NË MËNYRË E CILA
I KONVENON POLI-
TIKËS.**

politika nuk është e paaftë. Ajo do të fillojë ti manipulojë këta gazetarë qytetarë në mënyrë e cila i konvenon politikës. Ndërsa për politikën çdo herë është më lehtë të manipulojë me një gazetar qytetar, sesa nga gazetar që e kupton politikën dhe din ti parashtrojë pyetjet e vërteta.

Përpunimi i teksit: **Maja Ivanovska**



NGA “VINÇAT” DERI TE “KAPANXHAT” – LAJMET E RREJSHME MES ETIKËS DHE NDËSHKIMEVE

IGOR K. ILIEVSKI

“Lajmet e rrejshme”, siç quhet sot manipulimi me informata, nga informimi i dozuar deri te dezinformimi i pastër, nuk janë as të reja, as të rralla. Përkundrazi, ato janë të përditshme. Nuk janë as veçanërisht diskrete, nga “vinçi bullgar” (Leka largohet nga “Maqedonia”: Arriti vinçi për ekzekutim nga Bullgaria) deri te përkulja para kapanxhës” ose dëb-ora e korrikut në Argjentinë.

"LAJMET E RREJSHME", SIÇ QUHET SOT MANIPULIMI ME INFORMATA, Nga informimi i dozuar deri te dezinformimi i pastër, nuk janë as të reja, as të rralla.

"Ae mbani mend një lajm që pretendonte, paramendoni "vinçi bullgar hyri në Maqedoni, do të largohet përmendorja e Lekës së Madh" – dhe pastaj një grup i vogël qytetarësh u mbledh në sheshin në Shkup ta mbrojnë përmendoren nga vinçi bullgar. Sot jemi dëshmitarë se të gjitha ato lajme të ashtuquajtura – ishin të rrejshme. Kishin për qëllim të manipulojnë, ta shqetësojnë popullin". Kështu e ilustroi kryeministri Zaev nevojën për mbrojtje nga lajmet e rrejshme në mbledhjen konstitutive të Grupit të aksionit për koordinimin e institucioneve shtetërore për luftën kundër dezinformatave dhe sulmeve mbi demokracinë, që u mbajt të enjten me iniciativë të Qeverisë.

"Lajmet e rrejshme", siç quhet sot manipulimi me informata, nga informimi i dozuar deri te dezinformimi i pastër, nuk janë as të reja, as të rralla. Përkundrazi, ato janë të përditshme. Nuk janë as veçanërisht diskrete, nga "vinçi bullgar" (Leka largohet nga "Maqedonia": Arriti vinçi për ekzekutim nga Bullgaria) deri te përkulja para kapanaxhës" ose dëbora e korrikut në Argjentinë.

Qëllimi, si dhe i çdo lajmi, është të arrihet teri te pjesa më e madhe e publikut, qoftë nga motive politike, si "vinça" dhe "kapanaxha", ose, thjeshtë, me motive "ekonomike", si karrem për klikime me zbulimin e dimrit në hemisferën jugore.

Qeveria paralajmëroi debat të gjerë dhe gjithëpërfshirëse me të gjitha palët

QEVERIA PARA-LAJMËROI DEBAT TË GJERË DHE GJITHËPËRFSHIRËSE ME TË GJITHA PALËT E INTERESUARA, GJEGJËSISHT, ME "MEDIAT, ORGANIZATAT CIVILE DHE TË MEDIAVE, GAZETARË DHE INDIVIDË QË JANË TË PËRCAKTUAR KUNDËR TË KEQES SË QUAJTUR LAJME TË RREJSHME"

e interesuara, gjegjësisht, me "mediat, organizatat civile dhe të mediave, gazetarë dhe individë që janë të përcaktuar kundër të keqes së quajtur lajme të rrejshme", përmes cilës duhet t'i definojë masat pro-aktive kundër dezinformimit të qëllimshëm.

Në pritje të rezultatit nga debatet e ardhshme, cilat janë mjetet që në momentin mund të aplikohen kundër "lajmeve të rrejshme"? Në përgjithësi, mund të ndahen në dy kategori, me fjalor policor, "të buta" dhe të forta.

Të parat janë matjet e plotësimit të standardeve profesionale gjatë informimit, posaçërisht Kodi i gazetarëve, ose vlerësimet e vërtetësisë së lajmeve dhe etikës së informimit.

Dy mjetet kryesore në këtë kategori janë internet – faqet për verifikimin e vërtetësisë së lajmeve dhe përmbajtja e standardeve profesionale, siç janë "Vërtetmatësi" dhe "Krithink", por edhe disa më të reja, siç është këshilli për etikë në media, Komisioni për ankesa i të cilit vepron pas të gjitha gjetjeve për shkelje të standardeve etike dhe profesionale në mediat. Por, Komisioni, pasi dhe kur t'i verifikojë shkeljet e standardeve, mund t'i shpreh vetëm sanksion "të butë – të kërkojë që "dezinformatori" ta publikojë vendimin në të njëjtin vend ku ka qenë i publikuar teksti/artikulli me të cilin është shkelur ligji. Vitin e

**KODI PENAL, I CILI
E SANKSIONON
"PËRHAPJEN E
MESAZHEVE", POR
VETËM NËSE SHKAK-
TON OSE "KRIJON
RREZIK NGA REAL-
IZIMI" I VEPRAVE SIÇ
ËSHTË TERRORIZMI,
"SHKAKTIM I URRE-
JTJES NACIOALE,
FETARE DHE RACORE,
PËRÇARJE DHE MOS-
TOLERANCË"**



(Mars, 2018) Në rrjetet sociale u paraqitën fotografi të kranit që ka arritur nga Bullgaria që më pas me atë të zhvendoset shtatorja e Mbretit maqedonas Aleksandri i Madh, i quajtur "Luftëtari mbi kalë". Qytetarët thonë se ky kran do ta heq shtatoren për nder të Ministrit grek për punë të jashtme, Nikos Koxijas.

kaluar Komisioni ka sjellë 38 vendime të tilla.

Kategoria e dytë, e "fortë" janë mundësitë për sanksionimin ligjor të shkeljeve të standardeve gazetare. Një nga mundësitë është Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendime dhe shpifje, në aplikimin e të cilit ka raste të padive nga

**LIGJI PËR TË DREJTAT
AUTORIALE DHE TË
DREJTAT E LIDHURA
ËSHTË MJET PËR
APLIKIMIN E "DHUN-
SHËM" TË STANDAR-
DEVE GAZETARE**

gazetarë kundër gazetarëve ose mediave, por kryesisht për shkak të prekjes personale për shkak të lajmit të botuar në media.

Në këtë sferë do të ishte edhe aplikimi i Ligjit për të drejtat autoriale, si mjet për aplikim " i standardeve gazetare me forcë".

Në fund, këtu është edhe Kodi penal, i cili e sanksionon "përhapjen e me-sazheve", por vetëm nëse shkakton ose "krijon rrezik nga realizimi" i veprave siç është terrorizmi, "shkaktim i urrejtjes nacionale, fetare dhe racore, përçarje dhe mostolerancë" ose " përhapje të materialit racist dhe ksenofob përmes sistemit kompjuterik".

Derisa kjo kategori e masave të "forta" ka efikasitet diskutabil në aplikimin, masat e "buta" janë padyshim efikase. Edhe faqet, edhe Komisioni me shpejtësi dhe me kohë reagojnë ndaj manipulimeve me informatat dhe ndaj shkeljeve të standardeve profesionale në gazetari. Ato janë padyshim efikase, por jo dhe efektive. Puna e tyre, edhe pse mjaft e rrit dukshmërinë e "lajmeve të rrejshme" dhe e rrit vetëdijen publike për këtë dukuri, nuk i ndalon ato.

Ndërkohë, lajmet e rrejshme vazhdojnë me tempo dhe entuzijazëm të njëjtë, nga cilado anë dhe nga cilat do motive, pa përgjegjësi reale për fjalën e shprehur. Për fat të keq, ende nuk ka vepër, siç është "terrorizëm verbal", për shem-



Nga lajme të rrejshme dhe gjuhë të urrejtjes deri në protesta të dhunshme. Protestë e kundërshtarëve të procesit për tejkalimin e çështjes maqedonase dhe greke, shkurt 2018. / FOTO: A. Stamatiu

**LAJMET E RREJSHME
VAZHDOJNË ME TEM-
PO DHE ENTUZIAZËM
TË NJËJTË, NGA CILA
DO ANË DHE NGA
CILAT DO MOTIVE,
PA PËRGJEGJËSI TË
VËRTETË PËR FJALËN
E SHPREHUR**

bull, për të cilin publiku mundet t'i padisë helmuesit me lajme të rrejshme.



nota bene

Censurimi dhe vetë- censurimi u shndërruan në mjete të pavlefshme të atyre që duan t'i kontrollojnë informatat dhe opinionin publik. Gazetaria qytetare i rrënoi kufijtë e vendosura nga strukturat e fuqive politike dhe financiare dhe hapi dekadë të re në shpërndarjen e informatave nëpër media dhe hapësirë publike. Nëse ndonjë redaktor vendos të ndalon publikimin e një artikulli të caktuar, informata e njëjtë e përgatitur nga një aktivist, për disa sekonda mund të bëhet virale.

INTERVISTË – Zoran Ivanov – gazetar

GAZETARIA QYTETARE ËSHTË MATERIE DINAMIKE QË E MODELON POLITIKËN

Mediat dhe gazetaria janë të nënshtruara ndaj ndryshimeve dinamike në kontekstin e zhvillimit të teknologjive të komunikimit dhe në kontekst të sistemeve politike, si në kuptimin pozitiv të fjalës (shpejtësi, qasje, publiku demokratik...), ashtu edhe në kuptimin negativ (lajme të rrejshme, gjuha e urrejtjes, manipulime, dominimi i biznesit dhe politikës...). Duke u nisur nga teza se gazetaria qytetare mund të kontribuojë për ndryshime pozitive shoqërore dhe politike, biseduam me një nga doajenët e gazetarisë maqedonase, Zoran Ivanov.

CIVIL Media: Çfarë është me rëndësi të dinë ata që dëshirojnë të merren me gazetari në ditën e sotme në kontekstet e dhëna?

IVANOV: Për secilin që dëshiron të bëhet gazetar, t'i kushtohet këtij profesioni, së pari duhet ta njeh veten. Ta njoftojë veten. Të skanohet si personalitet në tërë brendësinë e tij.

Profesioni gazetar, si rregull e pashkruar, e kërkon këtë nga çdo gazetar si fundament i profesionit. Gazetari duhet të jetë person me karakter. Të jetë i njerëzishëm, luftëtar për drejtësi, të jetë mjaft i guximshëm t'i shohë në sy edhe autoritet më të mëdha. Të mos ketë kompleksin e vlerës më të ulët, edhe më pak, të asaj më të lartë.

Gazetaria është profesion përgjegjshëm. Kërkon person me vlera të larta morale të cilat e bëjnë njeri me dinjitet. Vetëm karakteret e tilla do të bëhen gazetarë autoritarë. Sot çdo kush din shkrim-lexim. Nëse dëshirohet, zanati gazetar lehtë mësohet. Çdo njeri i ri është i arsimuar. Por kjo nuk është gjëja më e nevojshme që të bëhesh gazetar. Edhe më pak të jesh gazetar i mirë. Madje edhe më pak të jesh gazetar me autoritet. Kjo e fundit është e rëndësishme, sepse gazetaria është profesion publik. Nuk ka profesion më publik se gazetaria. As politikanët as yjet e estradës. Gazetarë përmes medias në të cilën punon ose në mënyrë individuale si autoritet gazetar, përmes produkteve të tij gazetare, mund të jetë prezent për çdo ditë në publik. Njerëzit e lexojnë e dëgjojnë dhe e shikojnë. Reagimet e tyre janë stresuese për gazetarin edhe kur janë pozitive. Por prania e tij e vazhdueshme publike, gazetarin e bën më prezentin në shoqëri dhe njëkohësisht edhe më përgjeg-



ZORAN IVANOV:

GAZETAR MUND TË QUHET ÇDO KUSH, POR GAZETAR MUND TË JETË VETËM AI QË MUND TA KUPTOJË FUQINË E FJALËS PUBLIKE DHE FUQINË E MEDIAS.

jës. Edhe si profesion edhe si person.

Nga këtu edhe fakti se jo çdo kush mund të bëhet gazetar. Gazetar mund të quhet çdo kush, por gazetar mund të jetë vetëm ai që mund ta kuptojë fuqinë e fjalës publike dhe fuqinë e medias. Që mundet që në fillimin e angazhimit gazetar të kuptojë se mjetet gazetare siç është pena, tani tastatura, mikrofoni, kamera dhe të gjitha tjerat që tani i ofron teknologjia informatike, janë mjete. Ato janë mjete të rrezikshme që guxojnë të jenë vetëm në duart e profesionistëve të përgjegjshëm zhurnalistikë. Nga arsyeja e thjeshtë se, nëse përdoren gabueshëm dhe pa etikë, ato mund ta dëmtojnë të vërtetën e cila është shembull elementar për punën gazetareske. Si plotësim, me keqpërdorimin e fuqisë gazetare, pozitës redaktore dhe të medias, ata munden ta pikëllojnë dikë pa arsye, ta lëndojnë ta traumatizojnë dhe ta deprimojnë. Nga ana tjetër, pikërisht gazetari dhe gazetaria, redaksia, media, janë subjektet për informimin e drejtë dhe faktografik të opinionit, për transmetimin autentik dhe interpretimin e ngjarjeve dhe për regjistrimin e dukurive.

**ZORAN IVANOV:**

TANI ME NDIHMËN E TEKNOLOGJISË, ÇDO KUSH MUND TË PLASOJË LAJME AUTENTIKE DHE TË ARGUMENTUARA DHE INFORMATA TJERA. POR, NË TË NJËJTËN KOHË ÇDO KUSH MUND TË JETË EDHE NË ROLIN E MANIPULUESIT, TË EMITTOJË INFORMATA TË RREJSHME, TË KRIJOJË FOTOGRAFI TË RREJSHME, DYSHIME, TË PAVËRTETA, TË NXISË URREJTJE

CIVIL Media: Si është kontributi i teknologjive të reja për gazetarinë?

IVANOV: Teknologjitë e reja gazetarisë i japin mundësi të reja, praktikisht pa kufij. Sot, duke i falënderuar pikërisht internetin dhe mjeteve të teknologjisë informatike, gazetari mund të jetë çdo kush, pa përjashtim. Mjeti të cilin të gjithë ne e posedojmë, ndërsa e cila ende sipas shprehisë quhet “telefoni mobil”, është një çudi multimediale, mjet gazetar me shumë mundësi. Me atë çdo kush mund të krijojë lajm, informatë me tekst dhe video nga cilado ngjarje në të cilën është gjetur me, ose pa qëllim. Në ndonjë rast të jashtëzakonshëm nga i cili mund të bëjmë lajm dhe ta plasojmë në opinion. Ta emitojmë shpejtë dhe me efikasitet deri te ndonjë redaksi, portal ose vetëm në profilin tonë në rrjetet sociale. Pastaj, varësisht nga atraktiviteti për opinionin më të gjerë ose më të ngushtë, kjo, pikërisht përmes këtyre mundësive të reja teknologjike, shpejtë bëhet me qasje për të gjithë. Lajmi, jo vetëm që arrin shpejtë deri te lexuesit e lajmeve, por edhe shpejtë formon qëndrime individuale ose kolektive në shoqëri. Për më tej, pikërisht interneti dhe prania e madhe aktive dhe pjesëmarrja e

publikut më të gjerë në rrjetet sociale, e formon ehe opinionin shoqëror demokratik. Pra, të gjithë ne si qytetarë njëkohësisht kemi mundësi edhe të krijojmë lajme edhe të komentojmë lajme edhe të marrim qëndrime të caktuara në lidhje me përmbajtjet e tyre. Të marrim pjesë në jetën sociale publike dhe të formojmë qëndrime të caktuara në lidhje me përmbajtjet e tyre. Të marrim pjesë në jetën publike sociale dhe të formojmë gjykime për çdo ngjarje.

CIVIL Media: Por, tregimi ka edhe anën tjetër...

